

**KOMENTET E KRYETARIT TË PREZENCËS
PAS TAKIMIT ME KRYETARIN E PARTISË SOCIALISTE**

23 shtator 2011

Çfarë diskutuat me z. Rama?

Wollfarth: “Patëm një shkëmbim shumë të mirë mendimesh për situatën politike aktuale. Një aspekt shumë i rëndësishëm është vizioni për integrimin evropian. Gjithashtu, folëm për aspekte të raportit tim më të fundit në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së në Vjenë, si dhe për mënyrat e angazhimit në Kuvend. Ndoshta ky është një hap themelor, një hap i parë themelor”.

A nënkupton angazhimi në Kuvend edhe miratimin e ligjeve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, pas mosarritjes së votimit të tyre dje në parlament?

Wollfarth: “Opozita, sigurisht, duhet të vendosë pas një diskutimi dhe dialogu të vërtetë në Kuvend, se si do të votojë. Por unë mendoj se është gjithashtu shumë e rëndësishme që të ketë qartësi dhe pozita të barabarta në rregulloren e parlamentit. Ky do të ishte një hap i parë shumë i rëndësishëm. Padyshim, do të ishte shumë mirë që të shihej se si është trajtuar ajo në të shkuarën, dhe që përfaqësuesit e qeverisë dhe të opozitës të jenë në pozicione të barabarta në Kuvend, në mënyrë që procesi të jetë i drejtë”.

Fund